

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 292119
Datë/Datum. 07.06.19
PRISHTINË - PRISTINA

Për: Ministria e Infrastrukturës

Për Aktivitetin e Prokurimit

Nr i prokurimit	205-19-1315-5-1-1
Nr i brendshëm	MI/19/016/511

Sa i përket tenderit për: Zgjerimi i rrugës Nacionale N2, segmenti Hyrja në qytetin e Prishtinës (Veternik)Ura dhe Zgjidhja e nyjës që lidhë rrugën Nacionale N2 dhe N25.2 dhe kyqjen e Autostradës R7

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Grupi i Operatorëve Ekonomik: "Rexha" sh.p.k. & N.N.T. "ABC"

Kroi i Bardhë, Lam1 nr.1 nr.107,

Prishtinë

10000

+383-046-121-213

Esat Rexha

rexhashpk18@gmail.com

07.06.2019

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për kontratë: 22.03.2019

Afati i fundit për dorëzim të tenderit: 06.05.2019;

Hapja e Ofertave me datën: 06.05.2019;

Kriteri për dhënien e kontratës: Çmimi më i ulët;

Njoftimi për dhënien e kontratës: 22.05.2019

Letra standard për tenderuesin e eliminuar: 22.05.2019;

Kërkese për rishqyrtim: 24.05.2019;

Vendimi për pezullim: 24.05.2019;

Vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për Rishqyrtim: 27.05.2019;

Kërkese dërguar Autoritetit Kontraktues për qasje në dokumentet e tenderit me datë: 31.05.2019;

Konfirmimi i Autoritetit Kontraktues për lejim në qasje të dokumenteve të tenderit: datën 03.06.2019;

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input type="checkbox"/>				Jo	<input checked="" type="checkbox"/>
----	--------------------------	--	--	--	----	-------------------------------------

Nuk kemi marrë pjesë në procesin e hapjes së tenderëve, për shkak që dorzimi i tenderëve ka qenë në mënyrë elektronike, dhe në të njëjtën mënyrë e kemi pranuar edhe ProcesVerbalin e Hapjes, të cilën e keni të bashkangjitur.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shpesh nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input checked="" type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------

Me datë 22.05.2019 nga Platforma e Prokurimit Elektronik kemi pranuar Letër standard për tenderuesin e eliminuar.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Infrastrukturës gjatë procesit të zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit dhe shpërblimit me kontratë të Grupit të operatorëve “Eskavatori” shpk & “Best Company” shpk, ka vepruar në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-241 dhe Ligji nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-237, ligjin nr.05/L-068 .

Shkeljen e dispozitave të LPP-së janë:

Neni 4 – Përkufizimet (pika 1.34);

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pika 1: Shkeljet e dispozitave të LPP-së:

Neni 4 - Përkufizimet (pika 1.34);

1.34. Tenderët e pa-përgjegjshëm - tenderët të cilët nuk janë në përputhje me a) dosjen e tenderit, duke përfshirë kërkesat teknike dhe kontraktuale, b) kërkesat e legjislacionit relevant të Kosovës ose të cilët c) përndryshe nuk përmbushin kërkesat e autoritetit kontraktues siç janë specifikuar në dosjen e tenderit.

Sipas ligjit, përkatësisht pikës së lartë shënuar, një tenderues llogaritet i papërgjegjshëm nëse nuk i përmbush të gjitha kërkesat e specifikuara në dosjen e tenderit, përkundër kësaj AK-ja ka shpallur fitues Grupin e Operatorëve Ekonomik “Eskavatori” shpk & “Best Company” shpk, edhe përkundër asaj që operatorët nuk e kanë përmbushur kërkesën si në vijim:

9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

2. Udhëheqës i punishtes Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, infrastrukturë rrugore me se paku 2 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit apo rikonstruktimit të rrugëve; minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar.

Dëshmia 2 CV, diploma e noterizuar, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

Gjatë kontrollimit të dokumentëve të OE-së fituese ne kemi parë që të njëjtët në kërkesën

për udhëheqës të punishtes, tek kërkesa për kontratën e punës me ofertuesin, kontratën e kanë bashkangjitur, por jo të noterizuar sic është kërkuar në dosjen e tenderit. Prandaj AK-ja ka propozuar për kontratë Operator Ekonomik të cilët nuk i kanë përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, me qw rast janw tw papwrgjegjshwm.

Gjithashtu kjo është e specifikuar edhe në nenin 69 të LPP-së, përkatësisht tek **Ligji nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-237, ligjin nr.05/L-068**

Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;

Pika 2: Autoriteti Kontraktues ka shpalle te suksesshem nje OE me çmim me te larte se sa oferta jone, kjo me arsyetimin se ne nuk i kemi permbushur kerkesat ne Aneksin 1, perkatesisht tek pika 12 dhe pika 16 e ketij aneksi.

Sipas AK-se tek pika 12 ne nuk kemi ofruar auto mikser per transportin e betonit me vellim me te madh ose baraz me 8m3. Perderisa tek pika 12 ne kemi ofruar 5 kamiona Auto miksera per transportin e betonit me vellim mbi 8m3 te cilat i kemi specifikuar edhe ne listen e paisjeve, gjithashtu ne kemi edhe shume te tjere te cilet ua kemi bashkangjitur dokumentat dhe jane ne listen e kompanise (Benita Company) me te cilen kemi bere marreveshje per shfrytezimin e makinerive per tenderin ne fjale. Ju mund ti gjeni faktet të bashkangjitura me këtë ankesë.

Gjithashtu sipas AK-se tek pika 16 e Aneksit 1 ne nuk kemi ofruar Cilinder me rrota te kombinuara 7-8t. Ne ne piken 16 kemi ofruar dy cilindra me kapacitet me te larte, perderisa kemi pasur edhe te tjere, (Makinerite e kompanise NNT "ABC"), te cilat po ua bashkangjesim edhe në këtë ankesë.

Bazuar në këtë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të mërret për bazë Ankesën tonë dhe lëndën ta kthejë në Ri-vlerësim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Dëmet e shkaktuara me rastin e përgaditjes voluminoze të ofertës, shpenzimet e Garancionit për sigurim të ofertës, fitimet e pritura gjatë realizimit të kontratës, shpenzimet e përgaditjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, shpenzimet e përgaditjes së ankesës të dërguar në OSHP, dhe shumë ore të punës gjatë komunikimit me Autoritetin Kontraktues.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*